




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-5493/23 datë: 24.02.2023



Npi – 01/66 datë: 01.03.2023

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 01.03.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 01.03.2023 (e mërkurë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamed Mehmeti, z.Arton Demiri dhe znj.Shkurte Mustafa. Në mbledhje përvèç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP-së, nga UNMIK-u znj.Arianita Beqa – Rraci dhe z.Sasha Ristiq.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshtëndetë të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 25.01.2023,
2. Përgatitja e listës definitive për ndërtim dhe riparim,
3. Projektet e planifikuara në Infrastrukturë në lagjet e banuara nga Komunitetet,
4. Vizita në shkollat fillore dhe të mesme ku ka nxënës të komuniteteve,
5. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Besnik Seferi; Përshtëndetje, kjo Shkurte Behluli si anëtar e këtij Komiteti ka disa mungesa radhazi, duhet me njellë disa arsyetime ose duhet me liruar pozitën për dikën tjetër. Kjo është jo serioze. Ky është Komitet obligator dhe nuk është mirë të mbahen mbledhje pas Kuvendit. Sa i përket pikave janë ashtu të planifikuara. Unë e pranoj këtë rend dite me këto pika.

z.Muhamed Mehmeti; Përshtëndetje, kërkoi ndjesë për shkak se nuk kemi mundur me mbajt mbledhjen para Kuvendit. Pikat i kemi bërë së bashku me zyrtarin e ZKKK-së Ibrahim Demiri. Po shpresoj që më nuk ndodhë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Kjo është mbledhja e parë që është mbajt pas mbledhjes së Kuvendit.

z.Besnik Seferi; Propozojë që në rendin e ditës me u futë Rregullorja për Taksa si dhe Raporti Financiarë si pika shtesë.

znj.Rrezartë Ramadani; Përshtëndetje, mendoj se është me rëndësi të diskutohet edhe për rregulloren e punës, mirëpo nuk kemi material dhe po votojmë vetëm për këto pika.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi renin e ditës.**

Pika 1
Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 25.01.2023

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 25.01.2023.**

Pika 2

Përgatitja e listës definitive për ndërtim dhe riparim

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fjalën ja dha z.Muhamed Mehmetit.

z.Muhamed Mehmeti; Unë e kam listën që e kam marrë prej zyrës të ZKKK-së. Nga kjo listë janë 2 shtëpi për ndërtim dhe 2 shtëpi për riparim. Lista e re për ndërtim i kemi 8 familje, ndërsa për riparim janë 15 familje.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Propozojë që ti Rekomandojmë Kryetarit dhe drejtorisë për disa familje.

z.Besnik Seferi; Ministria në mars po planifikon me hap një projekt për ndërtim. Ne duhet me verifikuar gjendjen në teren. Ne në teren duhet ti shikojmë mirë listën përfundimtare.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Ne mundemi bashkërisht të dalim në teren e ta bëjmë listën.

znj.Rrezartë Ramadani; Po pajtohem me dalë në teren e me bërë një listë. Kjo organizata “Jetimat e Ballkanit” e ka kusht që familja me pas tokë për ndërtim.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, ne duhet ti dimë ato listat e mëhershme e të dalim në teren dhe ti identifikojmë rastet që kanë nevojë. Propozoj që të dalim të premten.

z.Muhamed Mehmeti; Kemi dalë pak nga rendi i ditës, kjo është një listë nga ZKKK-ja, por nuk është definitive, unë e kam marrë me shikuar a ka nevojë me ndryshuar këtë listë apo jo.

znj.Arianita Beqa, UNMIK; Përshëndetje, a është ajo listë me ata që kanë aplikuar e nëse po atëherë ajo ka përfunduar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe është mbyllur me 20.02.2022.

z.Muhamed Mehmeti; Po, nga kjo listë janë disa persona.

z.Besnik Seferi; Mendoj se vetëm duhet ta caktojmë një ditë kur do të dalim. Të kemi një listë që ta dimë se ku do të shkojmë. Mendoj se këtë javë duhet ta kryejmë këtë punë.

****Komiteti për Komunitete, me 4 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” miratoi propozimin e Arton Demirit që të premten me dal në teren.**

Pika 3

Projektet e planifikuara në Infrastrukturë në lagjet e banuara nga Komunitetet (Drejtori i DSHP)

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Fjalën për këtë pikë ja dha z.Bardhyl Rushiti.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Përshëndetje për të gjithë. Mendoj se më e arsyeshme është që me qenë këtu drejtori i DPUKGJ-së, sepse ajo merret me projektimin e projekteve. Sa i përket mirëmbajtjes mund të them se është për te gjitha lagjet njësoj pa marr parasysh se të far komuniteti banojnë në atë lagje. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përgjigjem.

znj.Rrezartë Ramadani; A mundeni me na dhënë të dhëna se si është gjendja e grumbullimit të mbeturinave, dhe pagesat.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Nuk kamë të dhëna të sakta tani për tani.

z.Besnik Seferi; Sa i përket listës, është lista pa marr parasysh nacionalitetin, dhe ajo është listë e klientelës. Te shkolla e Gjyrkovcit e kam vërejt mungesën e sinjalistikës dhe ndriçimit, pastaj rruga, kanalizimet e trotuaret a ka planifikim për këto.

z.Bardhyl Rushiti, drejtor i DSHP; Dritat janë hargjuar, kontrata e mirëmbajtjes ka imbaruar dhe tani jemi në procedurë për kontratë të re e pastaj me filluar me i irregulluar ndriçimet.

z.Muhamed Mehmeti; Sa i përket kontratës na njoftove për kontratën e re. Faleminderit drejtor.

Pika 4

Vizita në shkollat fillore dhe të mesme ku ka nxënës të komuniteteve

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Në Planin e Punës e kemi edhe këtë pikë "Vizitat në shkollat fillore dhe të mesme ku ka nxënës të komuniteteve". Unë po e shoh se ka braktisje të madhe të nxënësve nga shkollat sidomos nëpër fshatra, dhe mendoj se ne duhet me ndërmarrë diçka.

z.Besnik Seferi; Ne duhet tra dimë paraprakisht se cila është qëllimi i vizitave. Ne kemi pas planifikuar edhe në të kaluarën, por nuk ka pas si temë braktisjen e shkollave. Ne duhet me ditë paraprakisht se çka mundemi me bërë ne në këtë drejtim.

z.Muhamed Mehmeti; Unë jam koordinator i qendrës të OJQ-së "Ballkan Sunflower" me qendër në Shtime. Te shkolla fillore "Naim Frashëri" i kemi 15 nxënës të komunitetit shumicë, ndërsa nga komuniteti pakicë i kemi 66 nxënës. Problemi është më i madh te shkolla e mesme nga klasa e 5 deri në të 12 ku i kemi 81 nxënës që e kanë braktisur shkollën.

znj.Rrezartë Ramadani; Pajtohem edhe unë që është e nevojshme për me bërë vizitë në teren, por ndoshta ata ose ato nuk donë me u takuar me neve, për këtë arsyen unë mendoj se ne duhet fillimisht me e takuar zyrtarin për punë sociale.

znj.Arianita Beqa-Rraci, përfaqësuese e UNMIK; Sa e di unë, secila Komunë e ka një mekanizëm për sa i përket fenomenit të braktisjes së shkollave, prandaj mendoj se do të ishte mirë që me konsultuar edhe këtë mundësi se çka ofron kjo strategji.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë jam pjesë e Komisionit, për braktisjen e shkollës, unë e marr përgjegjësinë, për me shkuar te familjet, sepse nuk besoj që na refuzojnë.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht u pajtua për me dalë në teren dhe me i vizituuar familjet që kanë fëmijë të cilët e kanë braktisur shkollën.**

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15.35h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

Për 